

- VENDIM -

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot ne daten 13.12 1999, une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi studjova dokumentet e paraqitura nga kerkuesi ENVER ZENKU dhe BEYAZIT BALKAN, te cilet kerkojne te regjistrojne si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "BOSFOR TRAVEL" shpk, Tirane

KONSTATOVA,

Shoqeria Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar "BOSFOR TRAVEL" shpk, Tirane, ka paraqitur kerkese per t'u regjistruar si person juridik per te fituar zotesine per te vepruar.

Objekti i shoqerise do te jete:

Transport Nderkombetar Udhetaresh (tokesor, ajror, detar), tregti me shumice dhe pakice te artikujve industriale e ushqimore, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, Bar, Restorant, Hoteleri dhe cdo aktivitet tjeter qe vjen ne interes te shoqerise.

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, Rr. " Mine Peza ", ish Pasticeri FLORA.

Administrator te shoqerise do te jene te dy ortaket Z. ENVER ZENKU dhe Z. BEYAZIT BALKAN.

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke, i ndare :
ENVER ZENKU, 50% te kapitalit, ose 50.000 leke.
BEYAZIT BALKAN, 50% te kapitalit, ose 50.000 leke.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

Kerkesa e tyre eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 dt 19.11.1992 per shoqerite tregtare si dhe ligjit 7667 dt 28.1.1993 per regjistrin tregtar,

VENDOSA

Te regjistroje si person juridik te kufizuar "BOSFOR TRAVEL" shpk, me ortak Z. ENVER ZENKU dhe Z. BEYAZIT BALKAN per te ushtruar veprimtarine tregtare ne fushen e:

Shoqerine Tregtare me pergjegjesi

Transport Nderkombetar Udhetarësh (tokesor, ajror, detar), tregti me shumice dhe pakice te artikujve industriale e ushqimore, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, Bar, Restorant, Hoteleri dhe cdo aktivitet tjeter qe vjen ne interes te shoqerise.

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, Rr. " Mine Peza ", ish Pasticeri FLORA.

Administrator te shoqerise do te jene te dy ortakët Z. ENVER ZENKU dhe Z. BEYAZIT BALKAN.


Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke, i ndare :
ENVER ZENKU, 50% te kapitalit, ose 50.000 leke.
BEYAZIT BALKAN, 50% te kapitalit, ose 50.000 leke.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim .

13.12.1989

GYOTARE



Tirane, me 02.05.01

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me date 02.05.2001, une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane Enkela Bajo, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit Enver Zenku dhe Besnik Dervishi, ortak dhe administrator te shoqerise "Bosfor Travel" shpk, dhe

KONSTATOVA SE :

Me vendimin nr. 22423 date 13.12.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria "Bosfor Travel" shpk, me ortak dhe administrator z. Enver Zenku dhe z. Beyazit Balkan, me seli ne Tirane.

Me vendimin e asamblese se ortakeve nr. 1 date 12.03.2001 eshte vendosur largimi nga shoqeria si ortak dhe administrator i z. Beyazit Balkan dhe shitja e pjeses se tij te kapitalit ne kete shoqeri ne masen 50 % z. Besnik Dervishi, nepermjet kontrates se shitjes se kuotave nr. 2587 rep dhe nr. 451 kol date 23.04.2001. Pas ketij vendimi ortak dhe administrator te shoqerise mbeten z. Enver Zenku zoterues i 50 % te kuotave te kapitalit te shoqerise dhe z. Besnik Dervishi zoterues i 50 % te kuotave te kapitalit te shoqerise "Bosfor Travel" shpk.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare dhe ligjit nr. 7667 date 28.01.1993 per Regjistrin Tregtar.

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimimin e vendimit te asamblese se ortakeve nr. 1 date 12.03.2001, kontrates se shitjes se kuotave nr. 2587 rep dhe 451 kol date 23.04.2001.

Urdherimin e zyres se regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese duke ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
ENKELA BAJO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 22423/1 Vendimit

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 8 05.2001, une gjyqtare e Gjykates se rrethit Tirane, B. Bay, pasi shqyrtova kerkesen dhe dokumentet e tjera te paraqitura nga kerkuesi ENVER ZENKU, Administrator i Shoqerise " BOSFOR TRAVEL " shpk,

K o n s t a t o v a ,

Me Vendimin Nr. 22423, date 13.12.1999 ne Gjykatën e Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik Shoqeria "BOSFOR TRAVEL " shpk, dhe vendimin nr. 22423/1 date 02.05.2001.

Me Vendimin date 16.05.2001 te Ortakeve te shoqerise " BOSFOR TRAVEL " shpk, Z. ENVER ZENKU dhe Z. BESNIK DERVISHI, eshte vendosur:

1. Te shtohet aktiviteti I shoqerise dhe per :

Shitje biletash per transport nderkombetar udhetaresh, agjensi per turizem, agjensi per shitjen e avio-biletave, agjensi per shitjen e biletave te traghteve, pra zyre per rezervimet dhe shitjen e biletave per linja te ndryshme nderkombetare te licensuara, zyra per organizimin e nisjes se autobuzave, te linjave nderkombetare te licensuara, zyre per nisjen e autobuzeve te linjave nderkombetare te licensuara.

Nga shqyrtimi rezultoi se kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshetjetje te nenit 24 dhe dispozitave te tjera te ligjit Nr. 7667, 7638 e 7632,

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses per depozitim ne Regjistrin Tregtar, te Vendimit te Ortakeve te shoqerise "BOSFOR TRAVEL " shpk, duke u shtuar objekti veprimtarise se shoqerise dhe per :

Shitje biletash per transport nderkombetar udhetaresh, agjensi per turizem, agjensi per shitjen e avio-biletave, agjensi per shitjen e biletave te traghteve, pra zyre per

rezervimet dhe shitjen e biletave per linja te ndryshme nderkombetare te licensuara, zyra per organizimin e nisjes se autobuzave, te linjave nderkombetare te licensuara, zyre per nisjen e autobuzeve te linjave nderkombetare te licensuara.

Urdherohet zyra e regjistrimit Tregetar te beje shenimet perkatese ne Kollonen 4, 5, Rreshti 2, Germa a..

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

Gulube Razi
Yezber.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
Nr. 22423/1 vendimit

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 11/10/2003 Une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles Pare Tirane *Mulla Cefo*, pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"Bosfor Travel" shpk** me ortak dhe Administrator te Pergjithshem te shoqerise z.Enver Zenku dhe z.Besnik Dervishi , me seli ne Tirane, per depozitim e dokumentave per ndryshime ne statutin e shoqerise shoqerise,

V E R E J :

Me vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr. 22423 date 13.12.1999 eshte themeluar shoqeria **"BOSFOR TRAVEL" shpk**, me ortak themelues Z. Enver Zenku me 50% te kuotave dhe z.Beyazit Balkan me 50% te kuotave te kapitalit, me objekt veprimtarie : *Transport nderkombetar Udhetaresh (tokesor,ajror, detar) tregtime shumice dhe pakice te artikujve industriale ushqimore,materiale ndertimi dhe hidrosanitare, bar, restaurant,hoteleri dhe cdo aktivitet tjeter qe vjen ne interes te shoqerise.*

Me vendimin nr. 22423/1 date 02.05.2001 eshte vendosur: *Shitja e kuotave te kapitalit ne masen 50% te kapitalit nga z. Beyazit Balkan tek z. Besnik Dervishi .*

Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortakët kane vendosur:

1. *Ndryshimin e emertimit te shoqerise nga "BOSFOR TRAVEL" sh.pk, ne "EURO SKY Travel & Tours Agency" shpk.*
2. *Riformulim te nenit 4 te statudit dhe shites te objektit te veprimtarise se shoqerise ne: Transport Nderkombetar udhetaresh (tokesor, ajror ,detar). Agjenci per shitje biletash per transport nderkombetar,udhetaresh (tokesor,ajror,detar) .Agjensi per sherbimtaksie ose radiotaksi.Agjensi per sherbime turizmi.*
3. *Shitjen e kuotave te z. Besnik Dervishi ne masen 20%, duke I mbetur ketij te fundit 30% te kuotave te kapitalit.*
4. *Administrator te shoqerise mbeten te dy ortakët Enver Zenku dhe Besnik Dervishi.*

Perfundimisht kapitali shoqerise **"EURO SKY Travel & Tours Agency" shpk**, perbehet **Z.Enver Zenku 70% te kapitalit te shoqerise dhe z. Besnik Dervishi 30% te kapitalit te shoqerise.**

*Depozitim e kerkeses prane Gjykates se shkalles se pare Tirane .

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993

V E N D O S A

*Pranimin e kerkeses.

*Depozitim e kerkeses dhe dokumentave te paraqitura nga shoqeria **"EURO SKY Travel & Tours Agency" shpk** Tirane duke u bere shenimet perkatse ne fleten e regjistrimit ne kollonen 3, kollona 4/c e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E

Mulla Cefo
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
Nr. 22 423/4 vendimit

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 16/3/2004 Une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles Pare Tirane _____ pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ **EURO SKY TRAVEL&TOURS AGENCY** ”Shpk me ortake te saj:

Z.Enver Zenku me banim ne Tirane ,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,

Z.Besnik Dervishi, me banim ne Tirane ,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,per depozitimin e dokumentave per ndryshime ne statutin e shoqerise shoqerise,

V E R E J :

Me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.22423 date 13.12.1999 eshte themeluar shoqeria “**EURO SKY TRAVEL&TOURS AGENCY**”sh.p.k me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” ortaket e shoqerise me vendimin date 13.3.2004 kane vendosur :

1-Ndryshimi i selise ne adrese: Bul “Zogu I”,Pall “Agimi”shpk,Kati I,Ap.3 prane Maternitetit,Tirane.

*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se shkalles se pare Tirane.
Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligi dhe si e tille te pranohet.

PER KETO ARSYE


Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993

V E N D O S A

*Pranimin e kerkeses.

*Depozitimin e kerkeses dhe dokumentave te paraqitura nga shoqeria “**EURO SKY TRAVEL&TOURS AGENCY** ” shpk duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrimit ne kollonen 3, kollona 4/c e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 22423 / 5

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 15.07 2005, unë A. Leco, Gjyqtare pranë Gjykatës së Shkalles së Pare, Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Euro Sky Travel & Tours Agency" Shpk, perfaqesuar nga Z. Enver Zenku, në cilësinë e Administratorit, për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakëve datë 30.06.2005, si dhe të dokumenteve të tjera perkates nga të cilat:

KONSTATOVA

Se Shoqëria "Euro Sky Travel & Tours Agency" Shpk. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 22423 datë 13.12.1999 të Gjykatës së Shkalles së Pare, Tiranë.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leke, i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1000 leke secila. Kapitali i shoqërisë zotërohet si vijon: ortakët Enver Zenku zotëron 70 kuota që perfaqesojnë 70% të kapitalit themeltar, ndërsa Besnik Dervishi zotëron 30 kuota që perfaqesojnë 30% të kapitalit themeltar.

Me datë 30.06.2005, pranë selisë së shoqërisë, sipas lajmërimit të bërë rregullisht u mbledh Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "Euro Sky Travel & Tours Agency" Shpk., e cila unanimisht, vendosi:

- 1) Të miratojë bilancin ushtrimor të shoqërisë "Euro Sky Travel & Tours Agency" Shpk. për vitin 2004 dhe pasqyrat perkatese financiare për vitin ushtrimor 2004. Fitimi neto i realizuar gjatë vitit ushtrimor 2004, përfshi fitimet e mbartura nga vitet paraardhëse është i barabartë me 3.052.029 (tre milion e pesëdhjetë e dy mijë e njetëzet e nente) Leke;
- 2) Të destinojë një shumë të barabartë me 152.602 (njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e dy) Leke, që përfaqëson 5% të fitimit pas tatimit, për krijimin e rezervës ligjore;
- 3) Të përdorë pjesën e mbetur të fitimit të realizuar sipas pikës 1 me siper për të zmadhuar në para kapitalin themeltar të shoqërisë me 2.899.427 (dy milion e teteqind e nentëdhjetë e nente mijë e katërqind e njetëzet e shtatë) Leke, duke rritur proporcionalisht vlerën nominale të kuotave të secilit ortak. Për këtë qëllim shoqëria do të kryej derdhjen e shumës prej 2.899.427 (dy milion e teteqind e nentëdhjetë e nente mijë e katërqind e njetëzet e shtatë) Leke pranë një banke për zmadhimin e kapitalit themeltar. Pas këtij zmadhimi kapitali i shoqërisë nga 100.000 Leke bëhet 2.999.427 (dy milion e nentëqind e nentëdhjetë e nente mijë e katërqind e njetëzet e shtatë) Leke. Në këtë mënyrë kapitali

ndahet ne 100 kuota me vlere nominale prej 29.994, 27 Leke secila, dhe zotërohet 70 kuota nga ortaku Enver Zenku, dhe 30 kuota nga ortaku Besnik Dervishi.

- 4) Pasi per mbarevajtjen e aktivitetit nevojitet nje zmadhim i metejshem i kapitalit, vendoset emerimi i Ing. Andrea Panozaqi, shtetas shqiptar, mbajtes i licenses profesionale nr. M0134 dhe Ing. Pirro Abdyli, shtetas shqiptar, mbajtës i licencës profesionale nr. SVP 0025 Shkalla I, si eksperte për vlerësimin e dy autobuse ne pronesi te shoqerise te markes: (i) Mitsubishi nr. Shasie NLTBG659EW1003625, nr. Targe TR 6287 H; Mercedes nr. Shasie 37319510217549, nr. Targe TR 8782 E. Eksperteve i ngarkohet detyra e vleresimit te autobuseve te mesiperm, ne menyre qe te kryhet zmadhimi i metejshem i kapitait me kontribute ne natyre.
- 5) Ngarkohet administratori Enver Zenku per te ndjekur procedurat perkatese per depozitimimin ne Regjistrin Tregtar te vendimit per zmadhimin e kapitalit ne para, dhe per emerimit te eksperteve per vleresimin e kontributeve ne natyre per nje zmadhim te metejshem te kapitalit.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqëritë Tregtare" dhe te ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitete qe duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare",

VENDOSA

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimit "Euro Sky Travel & Tours Agency" Shpk. Date 30.06.2005 dhe dokumenteve te tjera përkatës.
- Pas vendimit te zmadhimit te kapitalit ne para, kapitali i shoqërisë nga 100.000 Leke behet 2.999.427 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjete e nëntë mije e katërqind e njëzetë e shtate) Leke. Ne këtë mënyre kapitali ndahet ne 100 kuota me vlere nominale prej 29.994, 27 Leke secila, dhe zotërohet 70 kuota nga ortaku Enver Zenku, dhe 30 kuota nga ortaku Besnik Dervishi.
- Emërimin e Ing. Andrea Panozaqi, shtetas shqiptar, mbajtes i licenses profesionale nr. M0134 dhe Ing. Pirro Abdyli, shtetas shqiptar, mbajtës i licencës profesionale nr. SVP 0025 Shkalla I, per hartimin e raportit te vleresimit te kontributeve ne natyre per zmadhimin e metejshem te kapitalit.

Urdhërohet zyra e Regjistrin Tregtar te kryje ndryshimet ne kollonata përkatëse te Regjistrin Tregtar.

Kundër këtij Vendimi mund te behet Ankim.

GJYQTARE

Arion me Ceca

AS

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 22423 /6

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM
-PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE PERSONIT JURIDIK-

Sot me 19.07.2005, unë [Signature], Gjyqtare pranë Gjykatës së Shkalles së Pare, Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Euro Sky Travel & Tours Agency" Shpk, perfaqesuar nga Z. Enver Zenku, në cilësinë e Administratorit, për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakeve date 18.07.2005, si dhe të dokumenteve të tjera perkates nga të cilat:

KONSTATOVA

Se Shoqëria "Euro Sky Travel & Tours Agency" Shpk. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 22423 date 13.12.1999 të Gjykatës së Shkalles së Pare, Tiranë.

Siç rezulton nga vendimi nr. 22423/5 date 15.07.2005 i Gjykatës së Shkalles së Pare, Tiranë kapitali themeltar i shoqërisë "Euro Sky Travel & Tours Agency" Shpk. është 2.999.427 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzetë e shtatë) Leke.

Asambleja e Ortakeve, me vendimin 30.06.2005, depozituar në Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 22423/5 date 15.07.2005 të Gjykatës së Shkalles së Pare, Tiranë ka emëruar Ing. Andrea Panozaqi, shtetas shqiptar, mbajtës i licencës profesionale nr. M0134 dhe Ing. Pirro Abdyli, shtetas shqiptar, mbajtës i licencës profesionale nr. SVP 0025 Shkalla I si eksperte për vlerësimin e kontributeve në natyrë.

Me date 18.07.2005, pranë selisë së shoqërisë, sipas lajmërimit të bërë rregullisht u mbledh Asambleja e Ortakeve të shoqërisë "Euro Sky Travel & Tours Agency" Shpk., e cila unanimisht, vendosi:

- 1) Të miratojë raportin e Ing. Andrea Panozaqi, shtetas shqiptar, mbajtës i licenses profesionale nr. M0134 dhe Ing. Pirro Abdyli, shtetas shqiptar, mbajtës i licencës profesionale nr. SVP 0025 Shkalla I, emëruar me vendimin e Asamblesë date 30.06.2005, për vlerësimin e kontributeve në natyrë, dhe depozituar në Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 22423/5 date 15.07.2005 të Gjykatës së Shkalles së Pare, Tiranë.
- 2) Të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë me kontribute në natyrë me vlerën 2.240.000 (dy milion e dyqind e dyzetë mijë) Leke, duke rritur vlerën nominale të secilës kuote, dhe përkatësisht duke kaluar në kapital dy autobusë në pronësi të shoqërisë të markës: (i) Mitsubishi nr. Shasie NLTBG659EW1003625, nr. Targë TR 6287 H; Mercedes nr. Shasie 37319510217549, nr. Targë TR 8782 E, sipas vlerës së raportit të ekspertëve. Në këtë mënyrë, kapitali i Shoqërisë nga ai aktual prej 2.999.427 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzetë e shtatë) Leke siç rezulton nga vendimi nr. 22423/5 date 15.07.2005 i Gjykatës së Shkalles së Pare, Tiranë, bëhet 5.239.427 (pese

milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzetë e shtatë) Leke, i ndare në 100 kuota me vlerë nominale prej 52.394,27 (pesëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër presje njëzetë e shtatë) Leke secila, dhe i zotëruar 70 kuota nga ortaku Enver Zenku, dhe 30 kuota nga ortaku Besnik Dervishi.

- 3) Ngarkohet administratori Enver Zenku për të ndjekur procedurat përkatëse për depozitimin në Regjistrin Tregtar të vendimit për zmadhimin e kapitalit me kontribute në natyrë.

PER KETO ARSYE

Në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Mbi Shoqëritë Tregtare" dhe të ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitete që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare",


VENDOSA

- Pranimin e Kërkesës;
- Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Vendimit Asamblesë së Ortakeve të "Euro Sky Travel & Tours Agency" Shpk. datë 18.07.2005 dhe dokumenteve të tjera përkatës.
- Pas vendimit të zmadhimit të kapitalit me kontribute në natyrë, kapitali i shoqërisë nga ai aktual 2.999.427 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzetë e shtatë) Leke, bëhet 5.239.427 (pese milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzetë e shtatë) Leke i ndare në 100 kuota me vlerë nominale prej 52.394,27 (pesëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër presje njëzetë e shtatë) Leke secila, dhe i zotëruar 70 kuota nga ortaku Enver Zenku, dhe 30 kuota nga ortaku Besnik Dervishi.

Urdhërohet zyra e Regjistrit Tregtar të kryejë ndryshimet në kollonata përkatëse të Regjistrit Tregtar.

Kundër këtij Vendimi mund të bëhet Ankim.

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYGJSOR TIRANE

Nr. / Akti

22423 / F

VENDIM
" I GJYQTARIT TE VETEM "

Sot, me date 31/5/2007, une Gjyqtare 01/1, e Gjykates se Rrethit Gjygsor Tirane, pasi u njoha me materialet e paraqitura nga kerkuesi z.Enver Zenku, i biri i Raimit, i dt. 27.02.1965, i lindur ne Kercove, dhe banues ne Tirane, Bulevardi Zogu i Pare, Qendra Tregtare Tirane, dhe z. Besnik Dervishi, i bir i Qamilit, i dt. 17.02.1965, i lindur ne Berat, dhe banuese ne Tirane, Rr. "Komuna e Parisit", Selite e Vogel, Kompleksi Tirhino, prane Kopshtit Botanik, ne cilesine administratoreve te shoqerise "EURO SKY TRAVEL & TOURS AGENCY" shpk

KONSTATOVA

Se Shoqeria tregtare "Euro Sky Travel & Tours Agency" sh.p.k., eshte e regjistruar si person juridik shqiptar ne regjistrin tregtar me vendim te gjykates se rrethit gjygsor Tirane nr. 22423 date 13.02.1999. Ajo ka pesuar ndryshime nepermjet 6 (gjashte) depozitimeve (vendime te asamblese se ortakeve) ne regjistrin Tregtar te Gjykates se Tiranes. Aktualisht ajo rezulton e ortakave : 1. Enver Zenku me 70% te kapitalit dhe 2. Besnik Dervishi me 30% te kapitalit. Kapitali i shoqerise aktualisht eshte 5 239 427 leke.

Me date 23.04.2007, asambleja e ortakave te shoqerise, me unanimitet ka vendosur :


1. Te ndryshoje nenin 10 te Statutit te shoqerise per shkak te zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren prej 1 801 800 leke (nje milion e teteqind e nje mije e teteqind) duke e bere kapitalin e shoqerise ne vleren totale prej : 7 041 227 leke (shtate milione e dyzete e nje mije e dyqind e njezete e shtate leke)(nepermjet derdhjes se kontributit ne para nga ana e ortakave per rritje kapitali ne llogarine e shoqerise prane BKT dega Tirane, date 26.04.2007) (sipas Vertetimit Bankar Prot. nr. 196 date 26.04.2007 leshuar nga BKT Tirane)
 2. Te depozitohet ky vendim ne regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjygsor Tirane, per te reflektuar ndryshimin perkates.
- Kerkesen e paraqitur cmoj se eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

Per Keto Arsye

Ne baze te ligjit nr. 7638, date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe te nenit 33 te ligjit nr. 7667, date 28/01/1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

VENDOSA

1. Pranimin e kerkeses se paraqitur nga Administratoret e shoqerise tregtare "Euro Sky Travel & Tours Agency" shpk z. Enver Zenku dhe z. Besnik Dervishi,
2. Depozitimimin e vendimit te asamblese se ortakave te kesaj shoqerie nr.7 date 23.04.2007 mbi :
 1. Ndryshimin e nenit 10 te Statutit te shoqerise per shkak te zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise ne vleren prej 1 801 800 leke (nje milion e teteqind e nje mije e teteqind) duke e bere



kapitalin e shoqerise ne vleren totale prej : 7 041 227 leke (shtate milione e dyzete e nje mije e dyqind e njezete e shtate leke)(nepermjet derdhjes se kontributit ne para nga ana e ortakeve per rritje kapitali ne llogarine e shoqerise prane BKT dega Tirane, date 26.04.2007), (sipas vertetimit bankar Prot. nr. 196 date 26.04.2007 leshuar nga BKT Tirane)

2. Te depozitohet ky vendim si dhe dokumentet e tjera te bashkelidhura tij, ne regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjygsor Tirane, per te reflektuar ndryshimin perkates.
3. Ndarjen e regjistrimeve nga njeri tjetri me vize te kuqe.
4. Njoftimin e ketij vendimi kundrejt te gjitha subjekteve te interesuara;

Kunder vendimit lejohet ankim brenda afatit ligjor.

GJYQTARE

Alile 21/6

Ant

22 423

1

"Gas for travel" filed.

Re "Mumukshu" (the producer) Flora
Green

(c) Objekti: Perspektiv politiskultúra
forrás, írásművészet, művészet és feladat,
müvészeti - objektum

(c) Kapitali: 100.000 eksportue prece
pro ke Uperu Real keci

3. Administrator i shoqerise Enver Feri beu dhe Blegjiri
Bel fues

10. 12. 1977

13. 12. 1 PPP

Report no know

Nr 38. at p. 12. 1909

Henry Van Ness

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

" BOSFOR TRAVEL " SH P K



Sot me date 09.12.1999, ne Tirane,

1. ENVER ZENKU, i biri i Raimit dhe Asbijes, lindur me 27.02.1965, me shtetesi maqedonase, banues ne Tirane, me zotesi juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta nr. 0850904.

2. BEYAZIT BALKAN, i biri i Bajramit dhe Emines, lindur me 1962, me shtetasi turke, aktualisht banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta nr. TR-K Nr.893384.

Vendosem si ortake, te nenshkruajme Aktin e Themelimit te meposhtem per nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte "BOSFOR TRAVEL" shpk..

Neni 2

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rr. " Mine Peza ", ish Pasticeri FLORA.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit eshte i pakufizuar, mbi 10 vjet.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte :

Transport Nderkombetar Udhetaresh (tokesor, ajror, detar), tregti me shumice dhe pakice te artikujve industriale e ushqimore, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, Bar, Restorant, Hoteleri dhe cdo aktivitet tjeter qe vjen ne interes te shoqerise.

Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar.

Neni 5



Administrator te Shoqerise do te jene te dy ortaket Z. ENVER ZENKU dhe Z. BEYAZIT BALKAN.

Neni 6

Kapitali themeltar eshte 100.000 leke (njeqintmije), I ndare ne 100 pjese me vlere nga 1.000 leke (njemije) secila. Enver Zenku, 50% te kapitalit e barabarte me 50.000 leke dhe Beyazit Balkan 50% te kapitalit e barabarte me 50.000 leke.

Neni 7

Shoqeria do te filloje aktivitetin e saj vetem pas rregjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Neni 8

Shoqeria mund te hape filiale te saj ne qytete te tjera te Shqiperise e jashte saj per ushtrimin e aktivitetit.

Neni 9

Shoqeria do te paiset me dokumentin perkates me regjistrimin prane organit tatimor.

Neni 10

Fitimi qe do te rezultoje, pas heqjes se shpenzimeve te aktivitetit te njohura me ligj dhe pas zbritjes se shumave te tatimit, do te disponohet nga Ortaket e shoqerise sipas % te kapitalit.

Neni 11

Dispozita me te detajuara ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e shoqerise jane percaktuar ne Statutin e Shoqerise, bashkengjitur.

ORTAKET E SHOQERISE

ENVER ZENKU


BEYAZIT BALKAN

Beyazit BALKAN

S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" BOSFOR TRAVEL " SH P K



DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " BOSFOR TRAVEL " shpk, Tirane, eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuar ne Ligjin 7632, date 04.11.1992 te Kodit Tregtar, Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992, per Shoqerite Tregtare dhe akteve te tjera ligjore.

NENI 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

NENI 3

Ortaket e shoqerise ne kete sipermarrje kane derdhur kapitalin e tyre, me qellim qe te perfitojne te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

NENI 4

Shoqeria " BOSFOR TRAVEL " shpk, Tirane eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kompetent.

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje " AGJENCIA TURISTIKE BOSFOR TRAVEL - TIRANA- ALBANIA ".

EMRI, QENDRA, TERRITORI

NENI 5

Emri i Shoqerise eshte "BOSFOR TRAVEL " shpk, Tirane.

Neni 6

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rr. " Mine Peza ", ish pasticeri Flora. Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

AFATI I VEPRIMTARISE

NENI 7

Aktiviteti tregetar I Shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar, mbi 10 vjet.

OBJEKTI

NENI 8

Objekti I veprimtarise se Shoqerise eshte:

Transport Nderkombetar Udhetaresh (tokesor, ajror, detar), tregti me shumice dhe pakice te artikujve industriale e ushqimore, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, Bar, Restorant, Hoteleri dhe cdo aktivitet tjeter qe vjen ne interes te shoqerise

Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar.

NENI 9

Shoqeria "BOSFOR TRAVEL " shpk, mund te ndryshoje aktivitetin e saj. Ndryshimet ne aktivitetin e shoqerise, selise, shtimi dhe transferimi i kapitalit te saj, behen vetem me vendim te Ortakeve te shoqerise.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 10

Kapitali themeltar i shoqerise "BOSFOR TRAVEL " shpk, eshte 100.000 leke (njeqintmije), I ndare ne 100 pjese me vlere nga 1.000 leke (njemije) secila, te ndara :

ENVER ZENKU - 50% te kuotave, e barabarte me 50.000 leke;
BEYAZIT BALKAN - 50 te kuotave, e barabarte me 5.000 leke;



Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise.

NENI 11

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te tranferueshme ne rruge trashegimie.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri me akt noterial.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

NENI 13

Shoqeria "BOSFOR TRAVEL, shpk Tirane, do te kete si **Administrator** te dy ortaket Z. ENVER ZENKU dhe Z. BEYAZIT BALKAN. Ortaket e shoqerise kane kompetence te caktojne si administrator edhe person tjeter i cili nuk eshte ortak ne shoqeri.

NENI 14

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e shoqerise. Ai kryen te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

Neni 15

Ne marredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Ne rastet kur administratori eshte l emeruar nga ortaket e shoqerise, kryen te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise, me perjashtim te atyre qe nuk i jane lene ne kompetence.

NENI 16

Ortaket e shoqerise kane kompetence:

Te miratojne programin e shoqerise, te hartojne raportin e administrimit, inventaret, llogarite vjetore, te cilat hartohen brenda nje afati 6 mujor, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar;

Vendosin per shperberjen e shoqerise;

Vendosin per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;

Vendosin per trasferimin e kuotave.

Rregullojne marredheniet e punesimit e te shperblimit brenda shoqerise;



Sipas akteve ligjore shlyejne detyrimet ndaj organeve shteterore, personave juridike e fizike, vendas a te huaj.

Te gjitha vendimet e rendesishme per ndryshime ne statut merren me votim me shume se 50% te kapitalit te shoqerise.

NENI 17

Ne rast se administrimi I shoqerise kryhet nga nje administrator I zgjedhur posacerisht nga ortaket, keta te fundit miratojne aktet e administrimit brenda afateve te mesiperme dhe kane te drejte te informohen per veprimtarine e shoqerise si dhe te njihen me llogarite dhe dokumentet e shoqerise.

NENI 18

Administratori humbet detyren e ngarkuar ne rast te prishjes se shoqerise ose kur shkarkohet nga ortaket e shoqerise.

MAREDHENIET EKONOMIKE FINANCIARE

Neni 19

Shoqeria "Shoqeria "BOSFOR TRAVEL " shpk Tirane, mund te lidhe kontrata me sektoret shteterore drejteperdrejt me tregun e lire si dhe me persona juridike e fizike, vendas e te huaj, sipas legjislacionit ne fuqi per eksport-importet.

NENI 20

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga Administratori ose perrsona te tjere te autorizuar prej tij.

NENI 21

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

NENI 22

Sipas rregullave te caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve te tjera ligjore, shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqerore, etj. Sipas ligjit te tatimit mbi fitimin, percaktohen tatimet per veprimtarine tregtare te shoqerise.

Shoqeria ka te drejte te cele llogari likujduese prane bankave te vendit e te huaja ne Shqiperi dhe te kryeje veprimet e likujdimit nepermjet tyre.

NENI 23



Per sigurimin e veprimtarise ekonomike, shoqeria ka te drejte te vetefinancohet ne leke ose valute te huaj.

NENI 24

Te ardhurat nga veprimtaria private, do te sigurohen sipas cmimeve qe i cakton vete shoqeria. Cmimet dhe tarifat dhe te caktohen sipas kerkeses dhe ofertes.

NENI 25

Shoqeria ka te drejte te transferoje jashte shtetit kapitalin dhe pjesen e saj te fitimit ne valute. Per pjesen e fitimit qe transferohet jashte, shoqeria paguan nje tatim ne perqindje te shumes se fitimit qe transferohet.

NENI 26

Per pasqyrimin e aktivitetit tregtar, administratori ose persona te tjere te caktuar prej tij, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe regjistrat perkates sipas ligjit te vecante.

NENI 27

Veprimtaria ekonomiko financiare e shoqerise mbyllet ne fund te vitit kalendarik. Administratori eshte i detyruar te paraqesi balance periodike, balance vjetore se bashku me deklaraten e fitimeve dhe humbjeve dhe ti depozitoje ato ne organin financiar te juridiksionit perkates ku ushtron aktivitetin shoqeria.

MAREDHENIET E PUNESIMIT

NENI 28


Ortaket e Shoqerise vendosin per shtimin ose paksimin e numrit te ortakeve. Per personave te tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e Shoqerise , vendos Administratori.

NENI 29

Maredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas dispozitave ligjore te legjislacionit shqiptar.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 30



Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, shoqerore, etj. kalojne ne pronesi te Shoqerise.

NENI 31

Shperblimi per personat e punesuar ne veprimtarine e shoqerise "BOSFOR TRAVEL " shpk, caktohen sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga Administratori.

NENI 32

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit fillestar ne kapitalin baze.

NENI 33

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi I vitit financiar, te cilit I jane zbritur ose shtuar numrat respektive te humbjeve apo fitimeve te bartura nga vitet e meparshme.

NENI 34

Kur pushon aktiviteti I shoqerise , kapitali I mbetur, pasi shlyen te gjitha detyrimet, I takon Ortakeve sipas kontributit te kapitalit.

NENI 35

Fitimi I mbetur kalon ne pronesi te ortakeve, vetem pasi jane shlyer te gjitha detyrimet tatimore si dhe pagesat e mundshme per punonjesit e shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 36

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket e Shoqerise, vendosin brenda 4 muajve nga dita e konstatimit, mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise dhe mund te kerkojne ne gjykate prishjen e saj.

NENI 37

Gjykata mund ti ofroje shoqerise nje afat maksimal prej 6 muaj per te rregulluar gjendjen. Ajo nuk mund ta prishe shoqerine ne rast se ky rregullim eshte bere ne ditën ne te cilen ajo mblidhet per te marre vendim.



NENI 38

Ne rast se shoqeria nuk prishet , detyrohet te zvogeloje kapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe ka mbetur pa mbuluar.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 39

Shtimi i numrit te ortakeve behet me Vendim te Ortakeve, te cilet kane te drejten te bejne ndryshimet e nevojshme ne statut si dhe te hartojne dhe kontraten e perbashket me ortaket e tjere duke bere ndryshimet e nevojshme ne regjistrin tregtar prane Gjykates se rrethit Tirane.

NENI 40

Mosmarreveshjet e shoqerise ne maredhenie me persona juridike e fizike, vendas a te huaj, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, kur kjo nuk arrihet, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Tirane.


NENI 41

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, I referohet ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise" si dhe cdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar.

U nenshkrua ne Tirane, sot me date 10.12.1999


ORTAKET THEMELUES

ENVER ZENKU



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

BEYAZIT BALKAN



NR. 8381 REP
NR. 2115 KOL.

VERTETIM

Sot me date 10.12.1999 (nentedhjetenente), para meje Ariana Mallkuci, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " DURRESIT " Pall. 11, u paraqiten personalisht Z. Enver Zenku dhe Z. Beyazit Balkan, banuesa ne Tirane, me zotesi juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaportat nr. 9850904 dhe nr. TR-K 893384, te cilet nenshkruan statutin e mesiperm rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.



Sot ne daten 23.09.2001 (dymije e nje) perpara meje Mimoza Sadushaj, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. Durrës, Pall. 11, u paraqiten personalisht Z. Enver Zenku dhe Besnik Dervishi me zotesi te plote per te vepruar, me identitet si me siper, te cilet nenshkruan rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.



NOTERE



REPUBLIKA E SHQIPERISE

SHOQERIA "BOSFOR TRAVEL" SH.P.K.



VENDIM

I ORTAKEVE TE SHOQERISE

Nr. 1, date 12.03.2001

Sot ne daten 12.03.2001 ne ortaket e shoqerise "BOSFOR TRAVEL" sh.p.k, Tirane, shoqeri e regjistruar ne Gjykate me vendimin nr.22423, date 13.12.1999,

VENDOSEM :

1. Te largohet si ortak dhe administrator i shoqerise "BOSFOR TRAVEL" sh.p.k, Z. BEYAZIT BALKAN ne masen 50 % te kuotave , duke ja shitur kuotat e tij Z. Besnik Dervishi.
2. Te shtoje objektin e shoqerise ne agjensi per shitje biletash per transport nderkombetar udhetaresh , agjensi per turizem, agjensi per shitjen e avio biletave, agjensi per shitjen e biletave te traqeteve, pra zyre per rezervimet dhe shitjen e biletave, per linja te ndryshme nderkombetare te licensuara, zyra per organizimin e nisjes se autobuzave, te linjave nderkombetare te licensuara, zyre per nisjen e autobuzave te linjave nderkombetare te licensuara.
2. Ti behet kerkese Gjykates se Rrethit Tirane nga Administratori i shoqerise Z. Enver Zenku dhe Besnik Dervishi per tu bere shenimet ne regjistrin tregtar.

ORTAKET

ENVER ZENKU

Enver Zenku

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 2586 REP

NR KOL

BEYAZIT BALKAN

Beyazit Balkan

Chapart

VERTETIM

Sot ne daten ^{23.04} 2001 (dymije e nje), perpara meje MIMOZA SADUSHAJ, Notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " Durrësit" Pall. 11, u paraqiten personalisht Enver Zenku dhe Beyazit Balkan, banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, me

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHKOMB E NOTERAVE TIRANE
NR 157 REF DT 1.02.2000
VERTETOHEE NENIA ME QELIMIN
E DEKUMENTIT
KRRKUAR NGA
NOTERB ALIDA STAMBO

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

"BOSFOR TRAVEL" SH P K



Sotme date 09.12.1999, ne Tirane,

1. ENVER ZENKU, i biri i Raimit dhe Asbijes, lindur me 27.02.1965, me shtetesi maqedonase, banues ne Tirane, me zotesi juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta nr. 0850904.

2. BEYAZIT BALKAN, i biri i Bajramit dhe Emine, lindur me 1962, me shtetesi turke, aktualisht banues ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta nr. TR-K Nr.893384.

Vendosem si ortakë, te nenshkruajme Aktin e Themelimit te meposhtem per nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte "BOSFOR TRAVEL" shpk..

Neni 2

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rr. " Mine Peza ", ish Pasteri FLORA

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit eshte i pakufizuar, mbi 10 vjet.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte :


Transport Nderkombetar Udhetaresh (tokesor, ajror, detar), tregti me shumice dhe pakice te artikujve industriale e ushqimore, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, Bar, Restorant, Hoteleri dhe cdo aktivitet tjeter qe vjen ne interes te shoqerise.

Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar.

Neni 5

PULLE TAKSE





Administrator te Shoqërise do te jene te dy ortakët Z. ENVER ZENKU dhe Z. BEYAZIT BALKAN.

Neni 6

Kapitali themeltar eshte 100.000 leke (njeqintmije), I ndare ne 100 pjese me vlere nga 1.000 leke (njemije) secila. Enver Zenku, 50% te kapitalit e barabarte me 50.000 leke dhe Beyazit Balkan 50% te kapitalit e barabarte me 50.000 leke.

Neni 7

Shoqëria do te filloje aktivitetin e saj vetem pas rregjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Neni 8

Shoqëria mund te hape filiale te saj ne qytete te tjera te Shqiperise e jashte saj per ushtrimin e aktivitetit.

Neni 9

Shoqëria do te paiset me dokumentin perkates me regjistrimin prane organit tatimor.

Neni 10


Fitimi qe do te rezultoje, pas heqjes se shpenzimeve te aktivitetit te njohura me ligj dhe pas zbritjes se shumave te tatimit, do te disponohet nga Ortaket e shoqërise sipas % te kapitalit.

Neni 11


Dispozita me te detajuara ne lidhje me organizimin dhe funksionimin e shoqërise jane percaktuar ne Statutin e Shoqërise, bashkengjitur.

ORTAKET E SHOQËRISE

ENVER ZENKU



BEYAZIT BALKAN



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

NR 2587 REP

NR 451 KOL



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot ne daten 23.04.2001 (dymije E NJE) perpara meje MIMOZA SADUSHI, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " DURRESIT ", pall. 11, u paraqiten personalisht palet :

PALA SHITESE: BEYAZIT BALKAN, i biri i Bajramit dhe Emines, lindur me 1962, me shtetesi turke, banues ne Tirane madhor me zotesi juridike per te vepruar me nr pasaporte TR-K-893384.

PALA BLERESE: BESNIK DERVISHI, i ibiri i Qamilit lindur ne Pobrati Berat ne 1965 dhe banues ne Tirane madhor me zotesi juridike per te vepruar me nr leternjoftimi QH 066647.

OBJEKTI: Trasferim nepermjet shitjes te kuotave te ortakut Beyazit Balkan ,Z Besnik Dervishi, te shoqerise " Bosfor Travel" shpk, e regjistruar ne gjykate me vendimin Nr. 22423, date 13.12.1999.

Pala shitesse Beyazit Balkan eshte ortak i Shoqerise "Bosfor Travel. ", shpk, me 50% te kapitalit ose 50.300 leke se bashku me ortakun tjeter Z.Enver Zenku, i cili ka edhe ai 50% te kapitalit ose 50.000 leke.

Kuotat e tij ne kete shoqeri z. Beyazit Balkan, 50 % te kuotave baraz me 50.000 leke, deklarone se ka rene dakort t'ja shesi pales blerese Z.Besnik Dervishi, duke u bere ky i fundit ortak ne shoqeri " Bosfor Travel. " shpk, me nga 50 % te kuotave, baraz me nga 50.000 leke sejcili se bashku me ortakun tjeter Enver Zenku.

Pala blerese Z. Besnik Dervishi, deklarone eshte dakort te bleje kuotat e mesiperme, 50% baraz me 50.000 leke duke u bere keshtu ortake te shoqerise me nga 50 % te kuotave baraz me nga 50.000 leke sejcili, se bashku me ortakun tjeter Enver Zenku duke u likujduar menjehere jashte kesaj zyre.

Per kete shitje eshte dakort edhe ortaku Enver Zenku.

Palet nuk kane me detyrime te tjera karshi njeri tjetrit

Z Enver Zenku dhe Z Besnik Dervishi mbeten Administratore te Shoqerise.

Kontrata u hartua nga une Noteri ne kater kopje te njejta, nje kopje nga te cilat arshivohet ne arkiven time, nje kopje depozitohet ne Gjykate, dy kopjet e tjera l

dorezohen paleve, ju lexua paleve me ze te larte dhe qarte te cilet e kuptuan permbajtjen e saj dhe meqenese ajo shpreh vullnetin e tyre te lire dhe te plote e nenshkruan ate perpara meje dhe une e vertetoj ate sipas ligjit.

SHITES

BEYAZIT BALKAN

Beyazit BALKAN

Jam dakort Enver Zenku

Enver Zenku

BLERES

BESNIK DERVISHI

Besnik Dervishi

Derishi

NOTER



MIMOZA SADUSHI

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT
Drejtoria e Transporteve Tokesor

LEJE VEPRIMTARIE

PER
AGJENCI PER TRANSPORT NDERKOMBETAR UDHETARESH
DHE ORGANIZIM TRANSPORTI ME TAKSI
(ndalohet rreptesisht perdorimi i ketij dokumenti per udhetim me automjete)

Nr.10, date 07.06.2000

I JEPET :

Shoqerise "BOSFOR TRAVEL" Sh.p.k
Me administrator Z. Enver Zenku
Me Seli ne Tirane

per te kryer veprimtarine e agjencise per transport nderkombetar udhetaresh me te drejten e :

- 1.Zyres per rezervimet dhe shitjen e biletave, per linja te ndryshme nderkombetare te licensuara.
- 2.Zyres per organizimin e nisjes se autobusave te linjave nderkombetare te licensuara, kur ka kontrata me to.

Me kete **LEJE** jepet e drejta edhe per organizimin e sherbimit me taksi sipas lejeve individuale te çdo mjete te tille.

Perdorimi i kesaj **LEJE** si dokument per kryerjen e vete linjave nderkombetare ose per transport taksi, denohet me heqjen e lejes.

Afati i vlefshmerise te kesaj **LEJE** eshte deri me **07.06.2001**

SOKOL NAKO

MINISTER



(P)

22423 / 2
08.06.01

Z. E. Bazo
05.06.2001
05.06.2001

KERKESE

GYKATES SE RRETHIT TIRANE

KERKUES : ENVER ZENKU, Administrator I Shoqerise " BOSFOR TRAVEL", SHPK, me identitet te njohur prej meje.

OBJEKTI : Ndryshime ne statutin e shoqerise .

Une kerkuesi Enver Zenku , sipas dokumenteve bashkengjitur , jam Administrator i shoqerise " BOSFOR TRAVEL " sh.p.k., shoqeri e regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane, me Vendimin nr. 22423, date 13.12.1999.

Si ortak i vetem i shoqerise, kam vendosur te bej ndryshime ne Statut si me poshte :

1. Te shtohet aktiviteti I shoqerise dhe per :

Shitje biletash per transport nderkombetar udhetaresh, agjensi per turizem, agjensi per shitjen e avio-biletave, agjensi per shitjen e biletave te traghteve, pra zyre per rezervimet dhe shitjen e biletave per linja te ndryshme nderkombetare te licensuara, zyra per organizimin e nisjes se autobuzave, te linjave nderkombetare te licensuara, zyre per nisjen e autobuzeve te linjave nderkombetare te licensuara.

2. T'i behet kerkese gjykates se Rrethit Tirane, per te bere ndryshimet ne regjistrin tregetar te saj.

Kerkoj nga nga ana juaj si Gjykate te vendoset ne ky ndryshim te pasqyrohet ne regjistrin tregtar ku eshte regjistruar shoqeria ime.

KERKUESI

ENVER ZENKU

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

NR 2922 REP



VERTETIM

Sot ne daten 16.05.2001 (dymije e nje) perpara meje Arjana Mallkuci, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. Durrës, Pall. 11, u paraqit personalisht Z. Enver Zenku, Administrator i Shoqerise " BOSFOR TRAVEL " shpk, me zotesi te plote per te vepruar, me identitet te njohur prej meje, i cili nenshkroi rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj sipas identitetit te tij.

ARJANA MALLKUCI
RR. DURRESIT P. 11
TIRANE 250253

REPUBLIKA E SHQIPERISE

SHOQERIA "Bosfor Travel " SH.P.K.



V E N D I M

I O R T A K U T T E S H O Q E R I S E

Nr. 2, date 16.05.2001

Sot ne daten 16.05.2001 ne ortaket e shoqerise "BOSFOR TRAVEL " sh.p.k, Tirane, shoqeri e regjistruar ne Gjykate me vendimin nr.22423, date 13.12.1999,

V E N D O S E M :

1. Te shtohet aktiviteti I shoqerise dhe per :

Shitje biletash per transport nderkombetar udhetaresh, agjensi per turizem, agjensi per shitjen e avio-biletave, agjensi per shitjen e biletave te tragheteve, pra zyre per rezervimet dhe shitjen e biletave per linja te ndryshme nderkombetare te licensuara, zyra per organizimin e nisjes se autobuzave, te linjave nderkombetare te licensuara, zyre per nisjen e autobuzeve te linjave nderkombetare te licensuara.

2. Ti behet kerkese Gjykates se Rrethit Tirane nga Administratori i shoqerise Z. Enver ZENKU, per t'u bere shenimet ne rregjistrin Tregtar.

O R T A K E T

ENVER ZENKU
ENVER ZENKU

BESNIK DERVISHI
Besnik Dervishi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 2921 REP
NR 511 KOL

V E R T E T I M

Sot ne daten 16.05. 2001 (dymije e nje), perpara meje ARJANA MALLKUCI, Notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " Durrësit" Pall. 11, u paraqiten personalisht z.

22423/3
21.01.2003
3 A Cepo
13.01.2003

K E R K E S E: Shoqeria **"BOSFOR TRAVEL" Shpk** e perfaqesuâr nga Administratoret e shoqerise Z.Enver Zenku dhe Besnik Dervishi, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

OBJEKT: Depozitim e dokumentave te shoqerise **"BOSFOR TRAVEL" shpk** ne mbeshtetje te Ligjit 7667 dt. 28 janar 1993.

PERPARA: **GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**

T I R A N E

Me vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr. 22423 date 13.12.1999 eshte themeluar shoqeria **"BOSFOR TRAVEL" shpk**, me ortak themelues Z. Enver Zenku me 50% te kuotave dhe z.Beyazit Balkan me 50% te kuotave te kapitalit, me objekt veprimtarie :

Transport nderkombetar Udhetaresh (tokesor, ajror, detar) tregtime shumice dhe pakice te artikujve industriale ushqimore, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, bar, restaurant, hoteleri dhe cdo aktivitet tjeter qe vjen ne interes te shoqerise.

Me vendimin nr. 22423/1 date 02.05.2001 eshte vendosur:

Shitja e kuotave te kapitalit ne masen 50% te kapitalit nga z. Beyazit Balkan tek z. Besnik Dervishi.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortakët kane vendosur:

1. Ndryshimin e emertimit te shoqerise nga **"BOSFOR TRAVEL" sh.pk**, ne **"EURO SKY Travel & Tours Agency" shpk**.
2. Riformulim te nenit 4 te statutit dhe shtes te objektit te veprimtarise se shoqerise ne: Transport Nderkombetar udhetaresh (tokesor, ajror, detar). Agjenci per shitje biletash per transport nderkombetar, udhetaresh (tokesor, ajror, detar). Agjenci per sherbimtaksie ose radiotaksi Agjensi per sherbime turizmi.
3. Shitjen e kuotave te z. Besnik Dervishi ne masen 20%, duke i mbetur keshtu te fundit 30% te kuotave te kapitalit.
4. Administrator te shoqerise mbeten te dy ortakët Enver Zenku dhe Besnik Dervishi.

Perfundimisht kapitali shoqerise **"EURO SKY Travel & Tours Agency" shpk**, perbehet Z.Enver Zenku 70% te kapitalit te shoqerise dhe z. Besnik dervishi 30% te kapitalit te shoqerise.

Sa siper i kerkoje Gjykates:

Te pranoj kerkesen per depozitim ne Regjistrin Tregtar te vendimit te ortakut te shoqerise **"BOSFOR TRAVEL" shpk**.

Bashkelidhur kerkeses jane:

1. Vendimi i Ortakeve te Shoqerise.
2. Vendimi i Gjykates se rrethit per regjistrimin si person juridik te shoqerise.

K E R R U E S I T

Administrator te Shoqerise
ENVER ZENKU BESNIK DERVISHI

Enver Zenku *Besnik Dervishi*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE Mimoza Shehu
Nr. 126 Rep
Nr. 20 Kol



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me daten 08.01.2003 ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje Noteres Mimoza Shehu u paraqiten personalisht te interesuarit si me poshte me cilesine e shitesit dhe te bleresave te cilet ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil si dhe te Ligjit "Per shoqerite tregtare" kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:

SHITESI: *Besnik Dervishi i biri i Qamilit, dtl. 17.12.1965, banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta e tij.*

DHE

